



UNMIK



IPVQ

INSTITUCIONET E PËRKOHSHME VETËQEVERISËSE NË KOSOVË  
 INSTITUCIJE PRIVREMENE SAMOUPRAVE NA KOSOVU  
 PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT OF KOSOVO

QEVERIA E KOSOVËS  
 Ministria e Shëndetësisë

GOVERNMENT OF KOSOVO  
 Ministry of Health

VLADA KOSOVA  
 Ministarstvo zdravstva

## Udhëzim Administrativ (Shëndetësi) 19 /2006

### Disperzimi i Listës Esenciale të Barërave në Kujdesin Parësor Shëndetësor

Ministria e shëndetësisë,

1. Bazuar në autorizimet e dhëna Ministrisë së Shëndetësisë (në tekstin në vijim MSH) me rregulloren 2002/5 Aneksi VI pika (i), krijon politikën dhe implementon ligjet e një sistemi jo diskriminues dhe të përgjegjshëm për kujdesin shëndetësor, pika (ii), koordinon aktivitetet në sektorin e shëndetësisë për të promovuar zhvillimin koherent të politikës për shëndetësi, pika (iii) vendos norma dhe standarde dhe nxjerr udhëzime për sektorin e shëndetësisë duke i respektuar standardet relevante ndërkombëtare;
2. Bazuar në VENDIMIN e Qeverisë së Kosovës Nr.08/212 të datës 23.08.06;
3. Bazuar në VENDIMIN ZMSH. Nr. 95-XII-06 të Ministrit të Shëndetësisë të datës 21.12.2006, për Disperzimin e barërave nga lista Esenciale nga Qendrat Kryesore të Mjekësisë Familjare;
4. Duke pas parasysh procesin e Decentralizimit të mëtutjeshëm të përgjegjësive në nivelin Komunal;
5. Bazuar në Statutet e Qendrave Kryesore të Mjekësisë Familjare (në tekstin në vijim QKMF);
6. Duke pas parasysh kost-efektivitetin e menaxhimit të mjeteve financiare për sektorin farmaceutik;
7. Me qëllim të përmirësimit të disperzimit të barërave nga lista esenciale (në tekstin në vijim LEB);

Ministria e shëndetësisë nxjerrë këtë Udhëzim Administrativ.



## **Neni 1**

### **Qëllimi**

- 1.1. Përcaktimi i përgjegjësisë së Drejtorive Komunale për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale (në tekstin në vijim DKSHMS) dhe QKMF për disperzimin e LEB;
- 1.2. Transferimi i përgjegjësisë për disperzimin e LEB nga Korporata Farmaceutike e Kosovës në DSHMS, gjegjësisht te QKMF;
- 1.3. Përcaktimi i kushteve që kanë të bëjnë me disperzimin e LEB;
- 1.4. Disperzimi i LEB;

## **Neni 2**

### **Detyrat dhe përgjegjësitë e DKSHMS/QKMF**

- 2.1. Me hyrjen në fuqi të këtij Udhëzimi Administrativ, Drejtoritë Komunale për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, gjegjësisht Qendrat Kryesore të Mjekësisë Familjare janë përgjegjëse për disperzimin e LEB;
- 2.2. QKMF përmes rrjetit të tyre të barnatoreve brenda njësisë të veta kanë për detyrë të bëjnë disperzimin e barërave nga LISTA ESENCIALE;
- 2.3. Brenda barnatoreve të QKMF nuk lejohet asnjë aktivitet tjetër komercial farmaceutik;
- 2.4. QKMF obligohen të raportojnë rregullisht lidhur me këtë aktivitet DKSHMS, Zyrat e Autoriteteve Shëndetësore të MSH (ZASHMSH), Kompanisë përgjegjëse për deponimin dhe distribuimin e LEB dhe Departamentin Farmaceutik të MSH, në format dhe kohën e paraparë nga MSH;

## **Neni 3**

### **Përgatitjet për transfer të përgjegjësisë**

- 3.1. Hapësirat e destinuara për barnatore në QKMF, duhet të vihen në dispozicion për këtë qëllim;
- 3.2. Ato QKMF të cilat këto hapësira i përdorin për qëllim të tjera apo të njëjtat përdoren nga shfrytëzues të tjerë, duhet brenda afatit ligjor ti përgatisin ato për këtë qëllim;
- 3.3. Departamenti i Prokurimit në MSH do të zbatojë procedurat e përfundimit të Kontratës për disperzimin e barërave nga lista esenciale;
- 3.4. Departamenti Farmaceutik i MSH bazuar në VENDIMIN ZMSH. Nr. 95-XII-06 të Ministrit të Shëndetësisë të datës 21.12.2006, do të obligojë të gjitha barnaret nën administrimin e KFK të bëjë regjistrimin e barërave nga lista esenciale, dhe të njëjtat barëra ti kthejë në depon qendrore;
- 3.5. Pas verifikimit të tyre nga një Komision i Ministrisë së Shëndetësisë, të njëjtat do të distribuohen në QKMF;



## Neni 4

### Kushtet për Disperzimin e LEB

Të gjitha DKSHMS dhe QKMF kanë për obligim

- 4.1. Të përgatisin dhe mirëmbajnë hapësirat e barnatoreve brenda QKMF dhe QMF sipas normave dhe kushteve të parapara për atë lloj institucioni;
- 4.2. Të përcaktojnë personat përgjegjës për Barnatoret në objektet e tyre;
- 4.3. Të identifikojnë personelin shëndetësor i cili do të punojë në barnatore;
- 4.4. Të dërgojnë në trajnim personelin e identifikuar, posa MSH me partnerët e saj të përgatis trajnimin adekuat për këta persona;

## Neni 5

### Disperzimi i LEB

- 5.1. Disperzimi i LEB do të bëhet në Barnatoret Qendrore të QKMF dhe në Barnatoret e QMF ku ekzistojnë kushtet e infrastrukturës dhe ku ka personel të trajnuar;
- 5.2. DKSHMS/QKMF duhet të sigurojnë punën në dy (2) ndërrime në së paku një barnatore brenda Komunës së vetë;
- 5.3. DKSHMS dhe QKMF duhet të vendosin në vend të dukshëm orarin dhe vendin e Barnatores kujdestare;
- 5.4. Disperzimi i LEB (deri në ndryshim të këtij UA) do të bëhet vetëm me Recetë të Mjekut të përgjithshëm, Specialistit të Mjekësisë Familjare dhe të mjekëve konsulentë në Kujdesin Parësor Shëndetësor;
- 5.5. LEB duhet të vendoset në vend të dukshëm në çdo njësi të QKMF;
- 5.6. Mjekët në KPSH duhet të informojnë pacientët nëse një bar nuk është në LEB;

## Neni 6

### Dispozitat kalimtare

- 7.1. Ky Udhëzim Administrativ hy në fuqi menjëherë me nënshkrimin nga ana e Ministrit të Shëndetësisë;
- 7.2. Obligohen të gjitha DKSHMS dhe QKMF të bëjnë përgatitjet e duhura brenda afatit të paraparë.

Prishtinë, 29.12.2006



Prof Sadik Idrizi

Ministër i Shëndetësisë

